



UNIVERSITETI I MITROVICËS
UNIVERSITY OF MITROVICA
“ISA BOLETINI”

Ukshin Kovaçica, 40 000 Mitrovicë, Republika e Kosovës
Tel: +381-28535725, [URL:http://www.umib.net](http://www.umib.net), Mail:rektorati@umib.net

RAPORT I TË HYRAVE DHE SHPENZIMEVE
PËR PERIUDHËN JANAR/SHTATOR - 2020

TETOR/2020

P Ë R M B A T J A

1. Hyrja.....	3
2. Analiza e Buxhetit.....	6
3. Pasqyra e realizimit të buxhetit e strukturuar sipas kategorive ekonomike	8
4. Shpalosja e pasqyrave të shpenzimeve të strukturuar nëpër kategori ekonomike...9	
4.1 Paga dhe mëditje	9
4.2 Mallra dhe shërbime.....	12
4.3 Shpenzime komunale.....	17
4.4 Subvencione dhe transfere.....	17
4.5 Investime kapitale.....	18
5. Të hyrat vetanake.....	21
5.1. Planifikimi i të hyrave vetanake.....	21
5.2. Të hyrat nga donacioni.....	23
5.3. Realizimi i të hyrave vetanake.....	23
5.4. Kthimi i mjeteve nga të hyrat vetanake.....	25

1. HYRJE

Bazuar në Ligjin mbi Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë Nr.03/L-048, neni 45 pika 45.2 lidhur me raportet tremujore buxhetore, Statutin e Përkohshëm të Universitetit të Mitrovicës neni 28 pika 1.9 dhe 1.10 mbi detyrat dhe përgjegjësitë e rektorit dhe neni 180 lidhur me procedurat buxhetore, rektori i Universitetit të Mitrovicës paraqet për aprovim raportin mbi planifikim dhe realizimin e të hyrave dhe shpenzimeve për periudhën janar-shtator të vitit fiskal 2020.

Raporti përmban një analizë përmbledhëse të performancës së aktiviteteve të planifikuara të cilat ndërlihen me objektivat e planifikuara sipas Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve 2020/2022, vendimeve nga niveli qendror (MF,MASH), rekomandimeve të Këshillit Drejtues dhe menaxhmentit.

Periudha raportuese për Universitetin e Mitrovicës, karakterizohet si sfiduese me faktin se aktivitetet e planifikuar ishin të kushtëzuara nga vonesa në aprovimin e Ligjit mbi Buxhetin, vendimet për luftimin/menaxhimin e Covid 19, vendimet e kushtëzuara nga Ministria e Financave lidhur me alokimin e mjeteve, reduktimin/zvogëlimit të masës buxhetore për kategoritë ekonomike sipas rishikimit të buxhetit për vitin fiskal 2020.

Raporti, përmes pasqyrave financiare, pasqyron se në ç 'mënyrë institucioni i Universitetit të Mitrovicës bazuar në Ligjin mbi Ndarjen Buxhetore dhe vendimin mbi ndryshimin e buxhetit për vitin 2020, administroi: burimet financiare dhe shpenzimet

Pasqyrat financiare për periudhën raportuese janë të bazuara në dokumentet:

1. Ligji mbi Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë-pasqyrimi i pasqyrave financiare.
2. Korniza Afatmesme e Shpenzimeve 2020-2022.
3. Ligji mbi Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2020.
4. Statuti i përkohshëm për UMIB.
5. Buxheti për vitin 2020 për UMIB
6. Rishikimi i buxhetit 2020 për UMIB
7. Vendimet e Ministrisë së Financave lidhur me racionalizimin e shpenzimeve dhe fondeve
8. Vendimet e Departamentit të Thesarit lidhur me ndërhyrjen buxhetore/përmbaruesi.
9. Planin e rrjedhës së parasë të bazuar në Ligjin mbi Ndarjen Buxhetore për vitin 2020 për Universitetin e Mitrovicës

Pasqyrat financiare janë të harmonizuara me të dhënat e sistemuara në Sistemin Informativ të Menaxhimit të Financave të Kosovës(SIMFK).

Buxheti për Universitetin e Mitrovicës i bazuar në Ligjin për Buxhetin të Republikës së Kosovës nr.07/L-001

Buxheti për UMIB i aprovuar në mars/2020 konform Ligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovës nr.07/L-001 është 4.211.245.00 euro që në krahasim me buxhetin të vitit 2019 është më i ulët për 577.724.00 euro ose me indeks prej 12.06% .

Buxheti i strukturuar nëpër kategori ekonomike

	KATEGORIA EKONOMIKE	Buxheti për vitin fiskal 2020
1.	PAGA DHE MËDITJE	2.879.706.00
2.	MALLRA DHE SHËRBIME	366.339.00
3.	SHPENZIME KOMUNALE	215.200.00
4.	SUBVENCIONE	100.000.00
5.	INVESTIME KAPITALE	650.000.00
6.	GJITHSEJ	4.211.245.00

Ligji nr.07/L-014 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 07/-001 mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2020.

Kuvendi I Kosovës me propozim të Qeverisë aprovoi kërkesën për ndryshim/rishikim të Ligjit me nr.07/-001 mbi buxhetin për vitin Fiskal 2020 .Buxheti për Universitetin e Mitrovicës bazuar në rishikim është 3.886.978.00 ose më i ulët për 324.267.00 euro në krahasim me buxhetin e aprovuar në mars/ 2020.

Zvogëlimi i buxhetit prej 324.267.00 euro reflektohet tek kategoritë ekonomike: mallra dhe shërbime, shpenzime komunale dhe investime kapitale

Buxheti i rishikuar i strukturuar sipas kategorive ekonomike

nr	KATEGORIA EKONOMIKE	Buxheti i aprovuar mars/2020	Buxheti i rishikuar për vitin 2020	Ndryshimi /zvogëlimi	Indeksi i ndryshimit
	1	2	3	4=2-3	5=3/2*100
1.	PAGA DHE MËDITJE	2.879.706.00	2.879.706.00		
2.	MALLRA DHE SHËRBIME	366.339.00	316.339.00	50.000.00	13.65
3.	SHPENZIME KOMUNALE	215.200.00	134.174.00	81.026.00	37.65
4.	SUBVENCIONE	100.000.00	100.000.00		
5.	INVESTIME KAPITALE	650.000.00	456.759.00	193.241.00	29.73
6.	GJITHSEJ	4.211.245.00	3.886.978.00	324.267.00	7.70



Paga dhe mëditje- masa buxhetore e rishikuar për përmbushjen e obligimeve për paga është 2.879.706.00 euro dhe në krahasim me buxhetin e aprovuar nuk ka pësuar ndryshime. Pjesëmarrja e buxhetit për paga dhe mëditje në strukturë është 74.08% të buxhetit të aprovuar.

Mallra dhe shërbime - Masa buxhetore e rishikuar për këtë kategori është 316.339.00 euro dhe është më e ulët për 50.000.00 euro ose me indeks të zvogëlimit për 13.65% në krahasim me buxhetin e aprovuar. Pjesëmarrja në buxhet për mallra dhe shërbime është 8.14%

Shpenzime Komunale- shpenzimet komunale janë 134.174.00 euro dhe janë të zvogëluara për 81.026.00 euro ose me indeks prej 37.65 % në krahasim me buxhetin e aprovuar. Pjesëmarrja në buxhet është 3.45%.

Subvencionet- mjetet e planifikuara janë në shumë prej 100.000.00 euro dhe janë në nivelin e buxhetit të aprovuar dhe me pjesëmarrje prej 2.57% të buxhetit të aprovuar.

Investime kapitale- Masa buxhetore për investimet kapitale me buxhetin e rishikuar është 456.759.00 euro që është për 193.241.00 euro më i ulët se buxheti i aprovuar për vitin 2020(650.00.00 euro).Pjesëmarrja në buxhetin total është me indeks prej 11.75%.

2. ANALIZA E BUXHETIT

Buxheti i strukturuar nëpër kategori ekonomike i bazuar në kufijtë final të aprovuar nga Kuvendi i Kosovës për Universitetin e Mitrovicës pasqyron mundësinë e realizimit të aktiviteteve të cilat ndërlidhen me fushëveprimin e Universiteteve publike.

Buxheti për UMIB-in i aprovuar në Mars/2020 konform Ligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovës nr.07/L-001 është 4.211.245.00 euro që në krahasim me buxhetin e vitit 2019 është më i ulët për 577.724.00 euro ose me indeks prej 12.06%.

Me propozim të Qeverisë së Kosovës, Kuvendi i Kosovës aprovoi rishikimin e buxhetit për vitin fiskal 2020. Propozimi ishte si rrjedhojë e krijimit të parakushteve për menaxhim të situatës së krijuar me COVID 19. Rishikimi i buxheti është reflektuar edhe për Universitetin e Mitrovicës.

Buxheti i rishikuar për UMIB është në shumë prej 3.886.978.00 euro ose më i ulët për 324.267.00 euro në krahasim me buxhetin e aprovuar në mars/2020 gjegjësisht për 901.991.00 në krahasim me buxhetin e vitit 2019.

Për periudhën raportuese (janar-shtator) janë alokuar mjete në shumë prej 2.605.115.36 euro ose 67.02% të buxhetit të aprovuar. Alokimi i mjeteve është bërë bazuar në Kompetencat e MF për alokimin e mjeteve konform nenit 24 të Ligjit mbi Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë.

Realizimi i buxhetit për të njëjtën periudhë është me indeks prej 84.62% (2.204.611.66 euro) bazuar në alokimin e mjeteve ose me indeks prej 56.71% në krahasim me buxhetin e rishikuar. Mjetet e angazhuara për këtë periudhë janë në shumë prej 2.432.560.46 euro ose 93.37% të mjeteve të alokuara.

Periudha janar/shtator karakterizohet për racionalizim të shpenzimeve duke përcaktuar edhe prioritetet që ndërlidhen me realizimin e kërkesave të njësive akademike dhe administratës qendrore. Vëmendje e posaçme ju kushtua racionalizimit të shpenzimeve me qëllim që mjetet e kursyera të orientohen në organizimin e funksionalizimit të bibliotekës dhe hapësirave që do të jenë në funksion të akomodimit/ambientit për studentëve dhe personelin e universitetit, procesit për riakreditim institucional dhe furnizim me pajisje që do të jenë në funksion të laboratorëve të njësive akademike.

Zyra për buxhet dhe financa bartëse e procesit dhe mbikëqyrjes së realizimit është përqendruar që kërkesat të jenë të harmonizuara me planifikimin e shpenzimeve të bazuar në planin e rrjedhës së parasë së gatshme për të njëjtën periudhë.

Periudha janar/shtator për shkak të specifikave në aspektin buxhetor dhe financiar karakterizohet mjaft sfiduese për faktin:

1. Vonesa në aprovimin e buxhetit,
2. Alokimit me vonesë të mjeteve për periudhën raportuese,
3. Ndërhyrja arbitrare e Thesarit në mjetet e planifikuara për investime kapitale.
4. Vendimet e MF për reduktim të masës buxhetore lidhur me situatën e krijuar COVID/19
5. Vendimet e MF lidhur me ndalesën e inicimit të procesit të prokurimit për investime kapitale.


6. Rishikimi i buxhetit dhe zvogëlimi i buxhetit për vitin fiskal 2020.

Aprovimi me vonesë i buxhetit, alokimit, vendimet e MF dhe rishikimi i buxhetit ndikuan që në masë të konsiderueshme mos të realizohen objektivat e planifikuara sipas KASH 2020/2020, Planit Strategjik (i rishikuar) për vitet 2019/2021 dhe objektivat lidhur me planifikimin e aktiviteteve për fillim të vitit të ri akademik 2020/2021. Zvogëlimi i buxhetit me rishikim është reflektuar në realizimin e aktiviteteve të planifikuara sidomos në kategorinë ekonomike mallra dhe shërbime dhe investime kapitale. Për këtë qëllim janë përcaktuar prioritetet duke prolonguar shumë aktivitete që ndërlihen edhe furnizim me pajisje për laborator të njësive akademike.

Përkundër vështirësive financiare, prolongim të afateve për alokim, periudha raportuese mund të konsiderohet si mjaft e suksesshme me faktin se janë realizuar aktivitetet për të cilat menaxhmenti i karakterizoi si prioritet. Indeksi i realizimit është 84.62 % në krahasim me buxhetin e alokuar dhe është më i lartë për 20.03 % në krahasim me indeksin e realizimit për periudhën e njëjtë të vitit fiskal 2019.

Në tabelën e poshtë shënuar është pasqyruar planifikimi, alokimi dhe realizimi i buxhetit për periudhën raportuese janar/shtator 2020.

Buxheti i rishikuar për vitin 2020	Alokimi Janar/shtator/2020	Mjetet e shpenzuara Janar/shtator 2020	Indeksi i realizimit në raport me buxhetin e rishikuar 2020	Indeksi i realizimit në raport me alokimin e mjeteve
1	2	3	$4=3/1*100$	$5=3/2*100$
3.886.978.00	2.605.115.36	2.204.611.66	56.71	84.62




Zyra për buxhet dhe financa bartëse e procesit të ekzekutimit dhe mbikëqyrjes së buxhetit, përmes pasqyrave financiare në mënyrë analitike do të pasqyrojnë si është bërë menaxhimi i parasë publike për periudhën raportuese, duke analizuar dhe bërë krahasime me planifikim, burimet dhe realizim të mjeteve të strukturuar nëpër kategori ekonomike.

3. Pasqyra e realizimit të buxhetit e strukturuar sipas kategorive ekonomike

Zyra për buxhet dhe financa bartëse e procesit të ekzekutimit dhe mbikëqyrjes së buxhetit përmes pasqyrave financiare pasqyron: si është bërë menaxhimi i parasë publike duke analizuar dhe bërë krahasime me planifikim, burimet dhe realizim të mjeteve të strukturuar në kategori ekonomike. **Për periudhën raportuese (janar-shtator)** janë alokuar mjete në shumë prej 2.605.115.36 euro ose 67.02% të buxhetit të rishikuar. Realizmi i buxhetit është me indeks prej 84.62 % (2.204.611.66 euro) bazuar në alokimin e mjeteve.

Në tabelën e poshtëshënuar është pasqyruar realizimi i buxhetit i krahasuar me burime, alokime, zotim, realizim dhe indeks të realizimit.

Kategoritë ekonomike	Buxheti rishikuar /2020	Alokimi Janar/shtator	Mjetet e shpenzuara Janar/shtator	Zotimet/ obligimet e pa shlyera	Mjetet e angazhuara	Mjetet e pashfrytëzuar	Mjetet e angazhuara në %	Shpenzimi i buxhetit në %
	1	2	3	4	5=3+4	6=2-5	7=5/2*100	8=3/2*100
Paga & Mëditje	2.879.706.00	1.668.884.02	1.668.884.02		1.668.884.02		100	100
Mallra&Shërbime	316.339.00	283.585.26	256.517.43	26.953.80	283.471.23	114.03	99.96	90.45
Shpenzime komunale	134.174.19	120.887.09	69.010.10		69.010.10	51.876.99	57.08	57.09
Subvencione	100.000.00	74.999.99	29.520.00		29.520.00	45.479.99	39.36	38.02
Kapitalet	456.759.00	456.759.00	180.680.11	200.995.00	381.675.11	75.083.89	83.56	39.30
Total	3.886.978.00	2.605.115.36	2.204.611.86	227.948.80	2.432.560.46	172.554.90	93.38	84.62



Pagat dhe mëditjet - janë alokuar 1.668.884.02 euro për përmbushjen e obligimeve për paga për personelit akademik të rregullt, të angazhuar dhe personelin administrativ. Për periudhën raportuese janë realizuar 1.668.884.02 euro ose me indeks të realizimit prej 100% përkatësisht janë shpenzuar mjete me indeks prej 57.95% të mjeteve të planifikuara (2.879.706.00 euro) sipas buxhetit të aprovuar.

Mallrat dhe shërbimet janë alokuar 283.585.26 euro ose me indeks prej 89.64% të mjeteve të planifikuara sipas buxhetit të rishikuar. Mjetet e alokuara janë realizuar në shumë prej 256.517.43 euro ose me indeks prej 90.45 % në krahasim me mjetet e alokuara.

Shpenzimet komunale janë alokuar 120.887.09, janë realizuar 69.010.10 euro ose me indeks prej 57.08% në krahasim me mjetet e alokuara.

Subvencionet dhe transferet – janë alokuar 74.999.99 euro, janë realizuar 29.520.00 ose me indeks prej 39.36% në krahasim me mjetet e alokuara.

Investimet kapitale -sipas planit të rrjedhës së parasë janë alokuar 456.759.00 mjete për investime kapitale, janë realizuar 180.680.11 euro ose me indeks të realizimit 39.55%

4. Shpalosja e pasqyrave të shpenzimeve të strukturuar nëpër kategori ekonomike.

4.1 PAGA DHE MËDITJE

Buxheti i aprovuar sipas Ligjit mbi Ndarjen Buxhetore për kategorinë ekonomike paga dhe mëditje është 2.879.706.00 euro i planifikuar për përmbushjen e obligimeve ndaj 195 të punësuarve (128 personel akademik dhe 67 personel administrativ) dhe 4 anëtar të KD të UMIB-it . Bazuar në strukturën organizative, numrin e planifikuar dhe rregulloren mbi të ardhurat personale të aprovuar nga Këshilli Drejtues i Universitetit të Mitrovicës, masa e planifikuar buxhetore mbulon të gjitha pozitat e planifikuara sipas strukturës organizative për personel akademik, administrativ dhe anëtar të KD.

Universiteti i Mitrovicës ka hartuar planin e personelit për vitin 2020 për administratë dhe personel akademik i cili është i bazuar në strukturën organizative të aprovuar, numrin aktual dhe numrin e vendeve të lira. Plani nënkupton edhe disponushmërinë e mjeteve për të mbuluar obligimet ndaj personelit aktual dhe plotësim të vendeve të lira.

Bazuar në numri e lejuar dhe buxhetin e aprovuar për paga dhe mëditje planifikohej që gjatë vitit fiskal të mbulohen të gjitha vendet e lira për personel akademik dhe administrativ. Në fillim të vitit me vendim të MAP është lejuar vazhdimi i procesit të rekrutimit të personelit administrativ të pezulluar me konkursin e vitit 2019. Procesi finalizohet me pranimin e personeli administrativ të bazuar në konkursin e shpallur.

Në tabelën e poshtë shënuar është pasqyruar realizimi i pagave për periudhën janar/shtator në raport me alokimin e mjeteve për të njëjtën periudhë.

Nr.	KATEGORIA EKONOMIKE	Paga e planifikuar bazuar në rishikim të buxhetit	Alokimi i mjeteve për periudhë Janar– Shtator/2020	Pagat e realizuara Janar- Shtator/ 2020	Indeksi i realizimit në raport me mjetet e alokuara për Janar Shtator/2020
	1	2	3	4	5=4/3*100
1.	PAGA DHE MËDITJE	2.879.706.00	1.668.884.02	1.668.884.02	100


Sipas planit të rrjedhës së parasë për periudhën raportuese është planifikuar (sipas rregullave të MF 1/12 e pagës totale) shuma prej 2.159.779.50 euro, janë alokuar 1.668.884.02 euro kurse janë shpenzuar 1.668.884.02 euro. Mjetet janë realizuar me indeks prej 100% në krahasim me mjetet e alokuara. Bazuar në metodologjinë e aplikuar nga MF,UMIB-i për këtë periudhë ka suficit për 490.895.48 euro. Mbetja do të shpërndahet varësisht nga nevoja për të plotësuar numri e pozitave të lira për vitin fiskal 2020.

Nr	Planifikimi I pagave për periudhën janar/shtator të bazuar në planin e rrjedhës së parasë për vitin 2020	Alokimi I mjeteve për periudhën janar/shtator	Realizimi I pagave për periudhën janar/ shtator	Mbetja e buxhetit për periudhën janar/shtator
	1	2	3	4=1-3
1	2.159.779.50	1.668.884.02	1.668.884.02	490.895.48

Pasqyra e realizimit të pagave të planifikuara, të strukturuar sipas realizimit mujor për UMIB


nr	UMIB	Personeli administrativ	shuma	Personel Akademik	shuma	Personel akademik i angazhuar	shuma	Anëtar i Keshillit Drejtues	Shuma	totali	shuma
1	JANAR	45	27.979.00	104	150.335.93	41		4	798.00	194	179.112.90
2	SHKURT	44	28.664.43	104	148.148.50	38	911.44	4	903.00	190	178.627.33
3	MARS	44	29.128.80	104	147.957.10	39	838.84	4	420.00	191	178.343.94
4	PRILL	47	30326.26	106	151.744.00	37	1691.35	4	420.00	194	184.382.69
5	MAJ	57	34.535.29	104	151.767.96	29	1.533.00	4	1.050.00	194	188.862.29
6	QERSHOR	57	35.031.29	105	156.868.30	33	8.811.60	4	903.00	199	201.614.18
7	KORRIK	57	34.734.24	105	151.435.31	32	1.071.63	4	903.00	198	188.144.20
8	GUSHT	56	34.311.28	105	153.163.11	33	158.55	4	903	198	188.536.64
9	SHTATOR	56	34.483.49	105	146.050.04	33		4	903	198	181.436.53
10	Gjithsej		289.194.10		1.357.470.30		15.016.41		7.203.00		1.668.884.00

Nga pasqyra e lartë shënuar vërehen se shuma prej 1.357.470.30 euro është shpërndarë për personelin akademik ose 81.34% të shumës së shpërndarë(1.668.884.00),për personelin akademik të angazhuar janë shpërndarë 15.016.41 euro ose 0.89% dhe për personelin administrative të strukturuar në administratën qendrore(rektorat) dhe njësitë akademike shuma prej 289.194.10 euro ose 17.32% dhe shuma prej 7.203.00 euro ose 0.42 të shumës së shpërndarë për periudhën raportuese.



Realizimi i pagave i strukturuar sipas njësive akademike dhe administratë qendrore

Njësia akademike	JANAR	SHKURT	MARS	PRILL	MAJ	QERSHOR	KORRIK	GUSHT	SHTATOR	totali
KËSHILLI DREJTUES	798	903	798	420	315	911.4	903	903	903	6854.4
FGJ	47454.75	46583.19	45041.11	44662.83	46491.33	47086.27	44656.35	44967.1	44127.31	411070.24
FIMK	31788.58	31410.35	32209.55	33258.96	33321.96	38362.18	33450.95	34548.83	33403.49	301754.85
FTU	34668.74	35082.12	35527.47	34556.4	37009.6	34995.77	34736.88	33917	32640.21	313134.19
EDUKIM	17644.81	17944.81	17045.85	18643.32	21437.29	27583.89	21130.01	21885.4	18562.78	181878.16
JURIDIK	14513.96	14333.23	15173.6	18040.49	15624.2	17684.3	16184.34	15757.71	15589.71	142901.54
EKONOMIK	17517.94	17644.9	17688.16	17428.49	17475.74	17779.19	17961.68	17677.97	16577.99	157752.06
REKTORATI	14726.12	14728.12	14860.21	17171.11	17211.18	17211.18	19120.99	18878	19632.02	153538.93
TOTALI	179112.9	178627.72	178343.95	184181.6	188886.3	201614.2	188144.2	188535	181436.5	1668884.37



Në pasqyrën për paga, personeli administrativ është inkorporuar nëpër njësi akademike sipas detyrës dhe përgjegjësisë për ofrim të shërbimeve administrative për student dhe njësi akademike.

Pasqyrë krahasuese e realizimit të pagave për vitet 2018/2020

Mjetet e realizuara për këtë periudhë janë më të ulëta 118.336.88 euro ose me indeks prej 6.62% në krahasim me realizimin për periudhën e njëjtë kohore të vitit 2019 dhe 96.462.26 euro në krahasim me vitin 2018.

Nr	periudha e raportimit	paga e realizuar	Minusi në paga/mbetja
1	periudha janar/shtator/2018	1.765.346.63	(188.139.36)
2	periudha janar/shtator/2019	1.787.221.25	280.221.00
3	periudha janar/shtator/2020	1.668.884.37	490.895.48

4.2 MALLRA DHE SHËRBIME

Për periudhën janar/shtator bazuar në planin e rrjedhës së parasë janë alokuar mjete në shumë prej 283.585.26 euro, janë realizuar 256.517.43 euro dhe mjete të zotuar në shumë prej 26.953.80 euro. Për periudhën raportuese janë angazhuar 283.471.23 euro ose me indeks të angazhimit prej 99.95% më krahasim me mjetet e alokuara.

Nr.	KATEGORIA EKONOMIKE	Planifikimi i mjeteve sipas buxhetit të rishikuar	Alokimi i mjeteve-janar/shtator	Mjetet e shpenzuara-janar/shtator	Mjetet e zotura-janar/shtator	Indeksi i realizimit
		1	2	3	4	5=3/2*100
1.	MALLRA DHE SHËRBIME	316.339.00	283.585.26	256.517.43	26.953.80	90.45

Në tabelën e poshtëshënuar janë pasqyruar shpenzimet të strukturuar nëpër kode ekonomike duke bërë krahasime me mjetet e planifikuara sipas ndarjes buxhetore, alokimin e mjeteve dhe realizimin për periudhën raportuese.

UNIVERSITETI I MITROVICËS (Granti qeveritar)

	13			
KATEGORIA EKONOMIKE	BUXHETI PËR VITIN 2020	ALOKIMI I MJETEVE JANAR-SHTATOR/2020	MJETET E SHPENZUARA JANAR-SHTATOR/2020	MJETET E SHPENZUARA NË %
	1	2	3	4 = 3:2*100
Mallrat dhe shërbimet	316,339.00	283,585.26	256,517.43	90
Shpenzimet e udhëtimit	12,000.00	12,000.00	6,095.71	51
Shpenzimet e udhëtimit brenda vendit				
Shpenzimet e udhëtimeve zyrtare jashtë vendit	12,000.00	12,000.00	6,095.71	51
Shpenzimet te vogla - para xhepi				
Akomodimi - udhëtimet zyrtare jash				
Shpenzime tjera - udhëtimeve zyrtar				
Shërbimet e telekomunikimit	21,500.00	15,712.86	6,622.04	42
Shpenzimet për Internet	1,800.00	1,458.31	236.78	
Shpenzime e telefonisë mobile	18,000.00	12,600.00	6,385.26	51
Shpenzimet postare	500.00	454.55		-
Shpenzimet për përdorim të kabllit optik	1,200.00	1,200.00		
Shpenzimet për shërbimet	56,239.00	56,239.00	29,405.19	52
Shërbimet e arsimit dhe trajnimit	7,500.00	7,500.00	330.00	4
Shërbimet e përfaqësimit dhe avokaturës	1,000.00	1,000.00		
Shërbime të ndryshme shëndetësore				
Shërbime të ndryshme intelektuale dhe këshillëdhënëse	1,000.00	1,000.00		
Shërbime shtypje-jo marketing	13,000.00	13,000.00		-
Shërbime kontraktuese tjera	31,739.00	31,739.00	28,365.19	89
Shërbimet teknike				
Shpenzimet për anëtarësim	2,000.00	2,000.00	710.00	36
Pagesa për Vendime Gjyqësore				
Blerja e mobilieve dhe pajisjeve më pak se 1000 Euro	32,000.00	26,867.00	116,045.96	432
Mobilje			109,847.22	
Telefona				
Kompjuterë	12,000.00	12,000.00		-
Harduer për teknologji informative				

Makina fotokopjuese				
Pajisje speciale mjekësore				
Pajisje të shërbimit policor				
Pajisje trafiku				
Pajisje tjera	20,000.00	14,867.00	6,198.74	42
Blerje tjera të mallrave dhe shërbimeve	14,500.00	10,500.00	1,030.80	10
Furnizime për zyrë	10,000.00	5,000.00	1,030.80	21
Furnizim me dokumente blanko	1,000.00	1,000.00		
Furnizim me ushqim dhe pije(- jo dreka zyrtare)	2,000.00	2,000.00		-
Furnizime mjekësore (organizata shëndetësore , qendrat e mjekësisë familjare)				
Furnizime pastrimi	500.00	500.00		
Furnizim me veshmbathje		1,000.00		
Furnizim me preparate kimike				
Akomodimi	1,000.00	1,000.00		-
Municion dhe armë zjarri				
Tiketa Siguruese				
Bllobat				
Derivatet dhe lëndët djegëse	4,000.00	3,270.40	1,544.66	47
Vaj				
Naftë për ngrohje qendrore				
Vaj për ngrohje				
Mazut				
Qymyr				
Dru				
Derivate për gjenerator				
Karburant për vetura	4,000.00	3,270.40	1,544.66	47
Llogarite e avansit	6,000.00	6,000.00	1,000.00	17
Avans për para te imëta(p.cash)	2,000.00	2,000.00	1,000.00	50
Avans për udhëtime zyrtare	4,000.00	4,000.00		

Shërbimet e regjistrimit dhe sigurimeve	53,600.00	46,768.80	37,896.00	81
Regjistrimi i automjeteve	3,100.00	3,100.00		
Regjistrimi dhe sigurimi i automjeteve				
Taksat komunale e regjistrimit të automjeteve	500.00	500.00		-
Sigurimi i ndërtesave dhe tjera	50,000.00	43,168.80	37,896.00	88
Mirëmbajtja	95,000.00	85,000.00	46,163.84	54
Mirëmbajtja dhe riparimi i automjeteve	2,500.00	2,500.00		-
Mirëmbajtja e ndërtesave	60,000.00	50,000.00	30,003.24	60
Mirëmbajtja e teknologjisë informative	30,000.00	30,000.00	14,967.00	50
Mirëmbajtja e mobilie dhe pajisjeve	2,500.00	2,500.00	1,193.60	48
Shpenzimet e marketingut	12,000.00	12,000.00	4,980.00	42
Reklamat dhe konkurset	5,000.00	5,000.00		-
Botimet e publikimeve	2,000.00	2,000.00		-
Shpenzimet për informim publik	5,000.00	5,000.00	4,980.00	100
Shpenzimet e përfaqësimit	8,500.00	8,227.20	5,448.40	66
Drekat zyrtare	8,500.00	8,227.20	5,448.40	66
Shpenzime për vendime të gjykatave	1,000.00	1,000.00	284.83	28
Shpenzime për vendime të gjykatave	1,000.00	1,000.00	284.83	28


Masa buxhetore e planifikuar për këtë kategori ekonomike nuk është e mjaftuar për realizimin e objektivave për funksionalizim të kampusit dhe proceseve që do të jenë në shërbim të mësimnxënjes dhe ngritjes së nivelit të shërbimeve të dedikuara për student. Gjendja financiare është përkeqësuar me rishikim të buxhetit. Buxheti i mallrave dhe shërbimeve me rishikim është zvogëluar për 50.000.00 euro që në masë të madhe ndikoi në realizim të aktiviteteve të planifikuara për periudhën raportuese.

Menaxhmenti dhe udhëheqësit e zyrave administrative, bazuar në gjendjen financiare, përcaktuan prioritete të reja duke bërë harmonizimin me masën e lejuar buxhetore. Racionalizimi i shpenzimeve dhe prioriteteve të përcaktuara mundësuan që masa buxhetore e planifikuar të realizohet me indeks prej 90.45%. Indeksi i realizuar konsiderohet i suksesshëm edhe me faktin që në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit 2019 është më i lartë për 63.61%.

Pasqyrë krahasuese e realizimit të shpenzimeve për mallra dhe shërbime për vite 2018/2020

Mjetet e realizuara për këtë periudhë janë më të larta për 16.903.75 euro për ose me indeks prej 7.05% në krahasim me realizimin për periudhën e njëjtë kohore të vitit 2019 dhe 94.452.75 euro në krahasim me vitin 2018 ose me indeks prej 58.28%

Nr	periudha e raportimit	shpenzimet e realizuara	Indeksi i realizimit
1	periudha janar/shtator/2018	162.064.68	58.65
2	periudha janar/shtator/2019	239.613.8	29.67
3	periudha janar/shtator/2020	256.517.43	90.45



4.3 SHPENZIMET KOMUNALE

Rishikimi i buxhetit reflektohet edhe në kategorinë shpenzime komunale me ç' rast masa buxhetore është zvogëluar për 81.025.81 euro. Buxheti i alokuar për këtë periudhë është në shumë prej 120.887.09 euro ose me indeks të alokimit prej 90.09 % në krahasim me buxhetin e rishikuar. Buxheti i rishikuar nuk është i mjaftuar për të mbuluar të gjitha shpenzimet e planifikuara për ngrohje dhe energji elektrike për objekte në kampus universitar.

Për këtë kategori janë alokuar mjete në shumë prej 120.887.09 euro duke shpenzuar 69.010.10 euro ose 57.08% të shumës së alokuar.

Nr.	KATEGORIA EKONOMIKE	Planifikimi sipas buxhetit të rishikuar	Alokimi i mjeteve	Shpenzimet e realizuara	Indeksi i realizimit
		1	2	3	4=3/2*100
1	SHPENZIME KOMUNALE	134.174.19	120.887.09	69.010.00	57.08

Në tabelën e poshtëshënuar, në mënyrë analitike, janë pasqyruar shpenzimet sipas kodeve ekonomike.

Nr	Përshkrimi	Buxheti sipas rishikimit	Alokimi i mjeteve	Shpenzimet e realizuara	Indeksi i realizimit
1	2	3	4	5	6=5/4*100
1.	E. elektrike	48,177.26	45,858.09	22,548.85	49
2.	H. e ujit	10,000.00	6,000.00	2,465.56	41
3.	Mbeturina	9,172.66	4,998.33	3,480.00	70
4.	Ngrohja qendrore	64,324.27	62,570.67	38,963.26	62
5.	PTK	2,500.00	1,460.00	1,552.43	106
6	Totali	134.174.19	120,887.09	69,010.10	57.08

4.4 SUBVENCIONE DHE TRANSFERE

Planifikimi i mjeteve buxhetore për kategorinë e subvencioneve në shumë prej 100.000.00 euro është bërë për t'i stimuluar studentët për lirim nga pagesa, të bazuara sipas rregulloreve për shërbimet e ofruara, si dhe stimulimin e studentëve të dalluar duke i shpërblyer me bursa të ndara nga UMIB-i.

Për periudhën raportuese janë alokuar mjete në shumë prej 74.999.99 euro, janë shpenzuar mjete në shumë prej 29.520.00 euro ose me indeks prej 39.39 të mjeteve të alokuara.


Nr.	KATEGORIA EKONOMIKE	Planifikimi sipas buxhetit të rishikuar	Alokimi mjeteve	Realizimi për janar/shtator/2020	Mjetet e pa shfrytëzuara	Indeksi i realizimit
		1	2	3	4=1-3	5=3/2*100
1	SUBVENCIONE DHE TRANSFERE	100.000.00	74.999.90	29.520.00	70.480.00	39.36

Bazuar në vendimin e Këshillit Drejtues është realizuar pjesa e mbetur për studentët të cilët ishin përfitues së bursave. Shuma prej 29.520.00 euro është realizuar për 72 student që do të thotë se është realizuar pjesa e dytë në shumë prej 410.00 euro për student. Pjesa e mbetur prej 70.480.00 euro do të realizohen bazuar në vendim të K.D.për stimulim të studentëve të dalluar.

Pasqyrë krahasuese e realizimit të bursave për student për vitet 2018/2020

Mjetet e realizuara për këtë periudhë janë më të ulëta për 26.980.00 euro ose me indeks prej 47.75% në krahasim me realizimin për periudhën e njëjtë kohore të vitit 2019 dhe më të ulëta për 479.75 euro në krahasim me vitin 2018.

Nr	periudha e raportimit	Realizimi i bursave	Indeksi i realizimit
1	periudha janar/shtator/2018	29.999.75	100
2	periudha janar/shtator/2019	56.500.00	56.50
3	periudha janar/shtator/2020	29.520.00	59.04



4.5 INVESTIMET KAPITALE

Bazuar në Ligjin mbi Ndarjen Buxhetore për këtë vit fiskal, për investime kapitale janë planifikuar mjete në shumë prej 650.000.00 euro që në krahasim me vitin 2019 masa buxhetore është zvogëluar për 200.000.00 ose me indeks prej 23.53%. Me rishikim të buxhetit mjetet janë zvogëluar për 193.241.00 euro ose me indeks prej 29.73% në krahasim me buxhetin e aprovuar për 2020 gjegjësisht 393.241.00 euro ose me indeks 46.26%. Masa e zvogëluar ndikoi edhe ndryshimin e buxhetit të strukturuar nëpër njësi akademike.

Pasqyrë e planifikimit të mjeteve për 2020 të strukturuar sipas njësive akademike

Nr.	Njësia akademike	Emërtimi i investimeve	Shuma
1.	Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike dhe Kompjuterike	<i>Furnizimi me pajisje të inxhinierisë mekanike dhe kompjuterike</i>	150.000.00
2.	Fakulteti i Gjeoshkencave	<i>Furnizimi me pajisje për laborator të gjeoshkencave</i>	150.000.00
3.	Fakulteti i Teknologjisë Ushqimore	<i>Furnizimi me pajisje për laborator të teknologjisë ushqimore</i>	245.000.00
4.	Rektorat/njësi akademike	<i>Furnizimi me pajisje për teknologji informative</i>	50.000.00
5.	Rektorat/njësi akademike	<i>Ndërtimi i infrastrukturës së universitetit/Kampusi</i>	30.000.00
	Rektorat/njësi akademike	<i>Furnizimi me pajisje për mirëmbajtjen e gjelbërimit</i>	25.000.00
6.	Gjithsej /2020		650.000.00

Pasqyrë e strukturës së investimeve kapitale sipas rishikimit të buxhetit

N r.	Njësia akademike	Emërtimi i investimeve	Buxheti i aprovuar	Buxheti i rishikuar	ndryshimi
1	2	3	4	5=3-4	
1	Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike dhe Kompjuterike	<i>Furnizimi me pajisje të inxhinierisë mekanike dhe kompjuterike</i>	150.000.00	75.000.00	75.000.00
2	Fakulteti i Gjeoshkencave	<i>Furnizimi me pajisje për laborator të gjeoshkencave</i>	150.000.00	84.332.00	65.668.00
3	Fakulteti i Teknologjisë Ushqimore	<i>Furnizimi me pajisje për laborator të teknologjisë ushqimore</i>	245.000.00	238.009.00	6.991.00
4	Rektorat/njësi akademike	<i>Furnizimi me pajisje për teknologji informative</i>	50.000.00	25.000.00	25.000.00
5	Rektorat/njësi akademike	<i>Ndërtimi i infrastrukturës së universitetit/Kampusi</i>	30.000.00	21.918.00	8.082.00
6	Rektorat/njësi akademike	<i>Furnizimi me pajisje për mirëmbajtjen e gjelbërimit</i>	25.000.00	12.500.00	12.500.00
7	Gjithsej /2020		650.000.00	456.759.00	193.241.00

Për periudhën raportuese bazuar në rishikim janë alokuar mjete në shumë prej 456.759.00 euro. ose me indeks prej 100% të buxhetit të rishikuar ,janë angazhuar mjete në shumë prej 408.628.91 euro ose 89.46 % .Për periudhën raportuese janë realizuar mjete në shumë prej 180.680.11 euro ose me indeks prej 39.55 % në krahasim me alokimin e buxhetit.

Ministria e Financave, përmes Thesarit në mënyrë arbitrare ndërhyri në buxhetin e planifikuar për investime kapitale duke bërë zvogëlimin për 78.664.65 euro dhe atë për projektet: furnizimi me pajisje për laboratorët e FTU 60.00.00 euro dhe FGJ 18.664.65.Ndërhyrja është bërë me qëllim të përmbushjes së obligimeve sipas vendimit të Gjykatës për personelin administrativ (ankesa).

Zyra për buxhet dhe financa bazuar në planin e rrjedhës së parasë ka planifikuar që mjetet të zotohen në muajin shkurt për të filluar me procesin e ofertimeve. Mirëpo për shkak të situatës së krijuar nuk kemi filluar me proceset e furnizimit me pajisje laboratorike për njësi akademike.

Vështirësitë e pasqyruara në realizim për investime kapitale:

1. Vonesa në aprovimin e buxhetit për 2020
2. Vonesa në alokimin e mjeteve sipas planit të rrjedhës së parasë
3. Ndërhyrja arbitrare nga Thesari për zvogëlim të mjeteve
4. Vendimi i MF për pezullim të përkohshëm të realizimit të investimeve
5. Vendimi për pezullim të përkohshme deri me aprovim të rishikimit të buxhetit.
6. Mos harmonizimi i alokimit dhe planit të rrjedhës së parasë/situata e impunuar/Covid/19.
7. Rishikimi i buxhetit për vitin 2020.

Në tabelën e poshtëshënuar është pasqyruar gjendja e realizimit të investimeve të planifikuara kapitale.

nr	Njësia akademike	Emërtimi i investimeve	Buxheti i planifikuar bazuar në Ligjin mbi buxhetin	Buxheti i rishikuar për vitin 2020	Alokimi i mjeteve janar/shtator	Realizimi për periudhë janar/shtator	Realizimi /ndërhyrja e Thesarit	Mjetet e zotuar	Mjetet e lira/te pashfrytëzues
1	2	3	4	5	6	7	8	9	
1	FIMK	Furnizimi me pajisje të inzhinierisë mekanike dhe kompjuterike	150.000,0	75.000,0	75.000,00				75.000,00
2	FGJ	Furnizimi me pajisje laborator të gjeoshkencave	150.000,0	84.332,00	84.332,00		18.664,6	65.667,40	
3	FTU	Furnizimi me pajisje laborator teknologjishë ushqimore	245.000,0	238.009,0	238.009,0	88.358,40	60.000,0	89.566,77	83,83
4	Rektorat	Furnizimi me pajisje teknologjishë informative	50.000,00	25.000,0	25.000,00			25.000,0	
5	Rektorat	Ndërtimi i infrastrukturës së universitetit/Kampusi	30.000,00	21.918,0	21.918,00	13.657,11		8.260,94	
6	Rektorat	Furnizimi me pajisje për mirëmbajtjen e gjelbërit	25.000,00	12.500,0	12.500,00			12.500,00	
7	Gjithsej		650.000,00	456.759,0	456.759,0	102.015,51	78.664,6	200.995,11	75.083


Pasqyrë e planifikimit, alokimit, zotimit dhe realizimit të mjeteve për periudhën janar/shtator/2020.

Nr.	KATEGORIA EKONOMIKE	Planifikimi sipas buxhetit të rishikuar	Alokimi i mjeteve	Realizimi për janar/shtator /2020	indeksi
1.		1	2	3	4=3/2*100
	Investime kapitale	456.759.00	456.759.00	180.680.11	39.55

Pasqyrë krahasuese e realizimit të investimeve për vitet 2018/2020

Mjetet e realizuara për këtë periudhë janë më të ulëta për 36.000.10 ose me indeks prej 16.68 % në krahasim me realizimin për periudhën e njëjtë kohore të vitit 2019 dhe më të larta për 95.214.84 euro në krahasim me vitin 2018.

Nr	periudha e raportimit	Realizimi i investimeve	Indeksi i realizimit
1	periudha janar/shtator/2018	85.465.27	28.34
2	periudha janar/shtator/2019	216.860.21	25.51
3	periudha janar/shtator/2020	180.680.11	39.55



5. T Ë HYRAT VETANAKE

5.1 Planifikimi i të hyrave vetanake për periudhën janar/shtator 2020


Të hyrat e planifikuara për periudhën raportuese janar/shtator/2020 janë 85.995.74 euro të planifikuara të inkasohen nga shërbimet e ofruara administrative për student. Planifikimi i të hyrave vetanake është bërë duke u bazuar në numrin e studentëve aktiv dhe lartësinë/çmimet e përcaktuara sipas Udhëzimit administrativ të MASHT-it me nr. 17/2014 për përcaktim të lartësisë së shërbimeve të ofruara për student.

Në tabelën e poshtëshënuar janë pasqyruar të hyrat vetanake të planifikuara dhe bartja e të hyrave vetanake nga viti fiskal 2019.

	THV të planifikuara sipas Ligjit mbi Buxhetin për vitin fiskal 2020	THV të planifikuara për periudhën janar/shtator/2020	THV të bartura nga viti 2019	Alokimi i THV për periudhën janar/shtator/2020
	1	2	3	4
1	114.661.00	85.995.74€	88.564.00€	88.564.00€

Pasqyrë e planifikimit të hyrave vetanake të strukturuar sipas njësive akademike

Përshkrimi i shërbimeve	FIMK	FTU	FGJ	EDUKIM	JURIDIK	EKONOMIK	TOTALI
Për certifikatë të diplomës	864.38 €	433.88 €	80.25 €	48.75 €	33.75 €	56.25 €	1,517.25 €
për certifikata të notave	865.13 €	434.63 €	195.00 €	894.38 €	485.63 €	232.50 €	3,107.25 €
për diplome	600.00 €	375.00 €	187.50 €	562.50 €	187.50 €	150.00 €	2,062.50 €
për diplome dublikatë	60.00 €	60.00 €	37.50 €	37.50 €	37.50 €	37.50 €	270.00 €
për paraqitje te provimeve master	375.00 €	2,100.00 €	900.00 €	0.00 €	0.00 €	0.00 €	3,375.00 €
Për mbrojtje te diplomës master	1,125.00 €	2,250.00 €	1,500.00 €	0.00 €	0.00 €	0.00 €	4,875.00 €
për provim pranues	900.00 €	1,500.00 €	750.00 €	2,302.50 €	1,125.00 €	1,125.00 €	7,702.50 €
për kërkesë për transferim te notave	37.50 €	38.25 €	39.00 €	39.75 €	40.50 €	41.25 €	236.25 €
për nderim të kartelës	7.50 €	8.25 €	9.00 €	9.75 €	10.50 €	11.25 €	56.25 €
për regjistrim te semestrit/bachelor	10,687.50 €	5,362.50 €	1,950.00 €	15,618.75 €	7,368.75 €	2,306.25 €	43,293.75 €
për regjistrim te semestrit/master	2,812.50 €	10,687.50 €	6,000.00 €	0.00 €	0.00 €	0.00 €	19,500.00 €
TOTALI	18,334.50 €	23,250.00 €	11,648.25 €	19,513.88 €	9,289.13 €	3,960.00 €	85,995.75 €



Pjesëmarrja e të hyrave vetanake varret nga numri i studentëve, lartësia për shërbime, azhureteti dhe përgjegjësia për ofrim të shërbimeve administrative. Shuma prej 18.334.50 euro është planifikuar nga FIMK dhe me pjesëmarrje prej 21.32% në të hyrat e planifikuara për periudhën raportuese , FTU me shumë prej 23.250.00 ero dhe pjesëmarrje prej 27.03%,FGJ me shumë prej 11.648.25 euro dhe pjesëmarrje prej 13.54%,F.i Edukimit me shumë prej 19.513.88 ose me pjesëmarrje prej 22.69%,F.Juridik

me shumë prej 9.289.13 dhe pjesëmarrje prej 10.80% dhe F. Ekonomik me shumë prej 3.960.00 dhe pjesëmarrje prej 4.60 %.

5.2 Të hyrat nga donacionet për vitin 2020

Universiteti i Mitrovicës është përfitues të projekteve nga Bashkësia Evropiane për përmirësimin e kulturës së kërkimeve, ngritje të cilësisë, metodave inovative, fuqizim i të rinjëve dhe grave dhe cilësisë së bashkëpunimit ndërkombëtarë. Për këto qëllime janë alokuar mjete në shumë prej 66.921.00 euro, janë shpenzuar 4.697.28 euro kurse shumat tjetër prej 62.233.72 do të realizohet sipas dinamikës së definuar në projekte.

Pasqyrë e projekteve të strukturuar sipas donatorit, alokimit dhe realizimit.

Përshkrimi	Buxheti Aktual	Të Alokua	Shpenzuar	Mbetja
Përmirësimi i Kulturës të Kërkimeve në Arsimin e Lartë	7,762.25€	7,762.25€	0.00€	7,762.25€
Ngritja e Profesionalizimit dhe Cilësisë Së Arsimin Fillestar	26,432.50€	26,432.50€	0.00€	26,432.50€
Metodat Inovative për Mësimdhënës të Matematikës	12,364.25€	12,364.25€	3,497.28€	8,866.97€
Fuqizimi i të Rinjëve dhe Grave drejt Punësimit	1,200.00€	1,200.00€	1,200.00€	0.00€
Zhvillimi i Cilësisë së Bashkëpunimit Ndërkombëtarë	5,362.00€	5,362.00€	0.00€	5,362.00€
Zhvillimi i Cilësisë së bashkëpunimit Ndërkombëtarë	13,800.00€	13,800.00€	0.00€	13,800.00€
Totali i Përgjithshëm	66,921.00€	66,921.00€	4,697.28€	62,233.72€

5.3 Realizimi i të hyrave vetanake për periudhën janar/shtator 2020

Bazuar në përgjegjësitë dhe kompetencat e dala nga Ligji mbi Arsimin e Lartë të Republikës së Kosovës, Statutit të Përkohshëm të Universitetit të Mitrovicës dhe udhëzimit administrativ të MASHT-it nr. 17/2014 për përcaktim të lartësisë së tarifave për ofrim të shërbimeve për studentë, për periudhën raportuese janë inkasuar të hyra në shumë 43.734.00 euro (niveli Bachelor dhe Master) të cilat janë të dedikuar vetëm për mbulimin e obligimeve për kategorinë paga dhe mëditje.

Indeksi i realizimit të grumbullimit të hyrave nga shërbimet e ofruara është 38.14% në krahasim me mjetet e planifikuara prej 114.661.00 euro ose 50.85% në krahasim me mjetet e planifikuara për periudhën raportuese.

Në tabelën e poshtëshënuar janë pasqyruar të hyrat vetanake të planifikuara, inkasimi, alokimi, dhe shpenzimet.

	THV të planifikuara sipas rishikimit të buxhetit	THV të planifikuara për periudhën janar/shtator/2020	THV të bartura nga viti 2019	Realizimi i THV për periudhën janar /shtator/ 2020	Alokimi i THV për periudhën janar/shtator/2020	Shpenzimi i THV për janar /shtator/2020
	1	2	3	4	5	6
1	114.661.00	85.995.74€	88.564.00€	43.734.00€	88.564.00€	

Pasqyrë krahasuese e realizimit të të hyrave për vitet 2018/2020


Realizimi i të hyrave vetanake në krahasim më të njëjtën periudhë të vitit fiskal 2019 është më i ulët për 9.724.50 euro ose me indeks prej 18.19% dhe për 10.675.00 euro më i ulët në krahasim me vitin 2018 dhe indeks prej 16.61%.

Nga të hyrat e realizuar është planifikuar që të bëhet shpenzimi për kategorinë ekonomike paga dhe mëditje.

Nr	periudha e raportimit	Realizimi i të hyrave	Indeksi i realizimit
1	periudha janar/shtator/2018	54.409.00	47.45
2	periudha janar/shtator/2019	53.458.50	46.62
3	periudha janar/shtator/2020	43.734.00	38.10

Pasqyrë e të hyrave të realizuara të strukturuar sipas njësive akademike

Përshkrimi i shërbimeve	FIMK	FTU	FGJ	EDUKIM	JURIDIK	EKONOMIK	TOTALI
Për certifikatë të diplomës	145.00€	30.00€	35.00€	310.00€	180.00€	110.00€	810.00€
për certifikata të notave	320.00€	140.00€	95.00€	197.50€	60.00€	25.00€	837.50€
për diplome	190.00€	120.00€	100.00€	310.00€	180.00€	110.00€	1,010.00€
për diplome dublikatë			25.00€	25.00€		50.00€	100.00€
për paraqitje te provimeve master	225.00€	855.00€	417.50€				1,497.50
Për mbrojtje te diplomës master	400.00€	1600.00€	400.00€				2,400.00€
për provim pranues	365.00€	115.00€	122.50€	1,130.00€	320.00€	320.00€	2,372.50€
për kërkesë për transferim te notave	8.50€	5.00€	9.50€	23.50€	5.00€		51.50€
për nderim të kartelës				5.00€			5.00€
për regjistrim te semestrit/bachelor	8,625.00€	3,175.00€	1475.00€	9,400.00€	4700.00€	1,575.00€	28,950.00€
për regjistrim te semestrit/master		4,350.00€	1350.00				5,700.00€
TOTALI	10,278.50€	10,390.00€	4029.50€	11,401.00€	5,445.00€	2,190.00€	43,734.00



5.4 Kthimi i të hyrave vetanake sipas vendimit të Këshillit Drejtues

Këshilli Drejtues bazuar në kompetencat sjell vendim për lirim/kthim të mjeteve për studentët të cilët kanë përmbush obligimet për regjistrim të semestrave për vit akademik 2020/2021. Komisioni bazuar në dokumentacionin e prezantuar ka bërë kthimin e mjeteve për të gjithë studentët të cilët kanë plotësuar kriteret e përcaktuara me vendim nga KD i UMIB-it.

Pasqyrë e kthimit të mjeteve për studentët e UMIB-it

Nr.	KATEGORIJA	Niveli bachellor		Niveli master		Totali 5=2+4	Komente
		1	2	3	4		
		Nr. Studentëve	Shuma	Nr. Studentëve	Shuma		Çmimi për studime bachellor 25.00 euro, master 150.00 euro.
1.	Dy apo më shumë student në familje	40	1.000.00€	5	750.00€	1.750.00€	
2.	Student – fëmijë të dëshmorëve /vetaran	1	25.00€	0	0	25.00€	
3.	Absolvent	2	50.00€	0	0	50.00€	
4.	Gabim në SMU	2	50.00€	0	0	50.00€	
	Totali		1.125.00€		750.00€	1.875.00€	